FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

ALCET

Tableta të veshura me film – 10 mg
(Cetirizinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Alcet dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Alcet
3. Si ta merrni Alcet
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Alcet
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË ALCET DHE PËRSE PËRDORET

Cetirizina, metabolit human i hidroksizinës, është antagonist potent i receptorëve H1 që nuk zotëron efekte të rëndësishme antikolinergjike dhe antiserotoninergjike. Në doza farmakologjikisht aktive, ajo nuk shkakton përgjumje dhe as ndryshime të sjelljes, e cila mund të shpjegohet me paaftësinë e saj për të kaluar barrierën hematoencefalike. Cetirizina frenon fazën e hershme të ndërmjetësuar nga histamina të reaksioneve alergjike dhe redukton gjithashtu edhe migrimin e qelizave të inflamacionit dhe çlirimin e mediatorëve që marrin pjesë në përgjigjen alergjike të vonuar. Cetirizina siguron gjithashtu një efekt mbrojtës kundrejt bronkospazmave të shkaktuara nga inhalimi i histaminës në ata që vuajnë nga astma bronkiale.
Pas administrimit oral, cetirizina përthithet shpejt nga trakti gastrointestinal, përqëndrimet plazmatike maksimale arrihen brenda një ore. Ushqimi rrit kohën e nevojshme për arritjen e përqëndrimit plazmatik maksimal por nuk e pakëson sasinë që përthithet. Cetirizina lidhet shumë me proteinat plazmatike dhe ka një gjysmë-jetë eliminimi rreth 10 orë. Ajo eliminohet kryesisht me ekskretim renal në pjesën më të madhe në formën e pandryshuar të barit.
Alcet indikohet në:

- të rritur dhe fëmijët mbi 6 vjeç në gjendjet alergjike duke përfshirë rinitin (rinit alergjik sezonal dhe rinit alergjik vjetor) si dhe në urtikarie idiopatike kronike;
- fëmijë 2-6 vjeç për trajtimin e rinitit alergjik sezonal.

Rinit alergjik sezonal: Alcet përdoret për lehtësimin e simptomave që shoqërojnë rinitin alergjik sezonal të shkaktuar nga alergjenë të ndryshëm, si pjalmi i pemëve apo bimëve të ndryshme. Alcet është mjaft e efektshme në trajtimin e simptomave të tilla si: tështimë, kruarje të hundëve, kruarje të syve, lotim dhe skuqje të syve.
Rinit alergjik vjetor: Alcet përdoret për lehtësimin e simptomave që shoqërojnë rinitin alergjik vjetor të shkaktuar nga alergjenë të ndryshëm si grimcat e pluhurit, apo në rastin e alergjisë nga kafshët apo kërpudhat. Alcet është mjaft e efektshme në trajtimin e simptomave të tilla si: tështimë, kruarje të hundëve, kruarje të syve, lotim të syve.
Urtikarie kronike: Alcet përdoret për trajtimin e manifestimeve të pandërlikuara në lëkurë të urtikaries kronike idiopatike. Ajo në mënyrë të dukshme redukton shfaqjen, përkeqësimin dhe kohëzgjatjen e urtikaries si dhe në mënyrë të dukshme pakëson kruarjen.

2. PËRPARA SE TË MERRNI ALCET

Mos merrni Alcet:

- në qoftë se jeni i ndjeshëm ndaj cetirizinës, hidroksizinës ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Alcet.

Tregoni kujdes të veçantë me Alcet.
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Alcet.

- Alcet duhet përdorur me kujdes në pacientët me disfunksion hepatik ose renal si dhe në moshat e vjetra sepse mund të ndryshojë farmakokinetika e cetirizinës dhe shpesh kërkohet modifikim doze.
- Afiniteti i Alcet për receptorët muskarinikë është i vogël dhe për këtë arsye mund të mos jenë të nevojshme kufizimet e rekomanduara për H1- antagonistët e tjerë.

Marrja e barnave të tjera:
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Alcet.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Alcet në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Ndërveprimet medikamentoze të cetirizinës janë të pakta dhe përgjithësisht të parëndësishme.
Megjithëse nuk janë gjetur ndërveprime medikamentoze klinikisht të rëndësishme me teofilinën në doza të vogla, duhet të kihet parasysh se si rezultat i një doze prej 400 mg teofilinë është vërejtur një pakësim i vogël në klirensin e cetirizinës; mundet që doza më të mëdha teofiline të kenë efekt më të madh.

Marrja e Alcet me ushqim dhe pije
Alcet mund të japë përgjumje dhe ky efekt mund t'i shtohet efektit sedativ të alkoolit. Duhet mënjanuar përdorimi i njëkohshëm i cetirizinës me alkool apo depresantë të tjerë të SNQ sepse mund të ndodhë një rënie e theksuar e vigjilencës si dhe shtim i dëmtimit të performancës së SNQ.

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Nuk ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me sigurinë e përdorimit të Alcet gjatë shtatzënisë. Për këtë arsye para se të përdoret duhet të konsultoheni me mjekun tuaj.

Ushqimi me gji
Nga studimet rezulton që cetirizina ekskretohet në qumështin e gjirit, ndaj dhe përdorimi i saj tek nënat që ushqejnë fëmijët me gji nuk rekomandohet.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Alcet përshkruhet si një antihistaminik jo-sedativ që ka fuqi shumë të ulët për të shkaktuar përgjumje, por gjatë përdorimit të saj ashtu si për të gjithë antihistaminikët, duhet treguar kujdes gjatë drejtimit të automjetit apo përdorimit të makinerive potencialisht të rrezikshme.

3. SI TA MERRNI ALCET

Gjithmonë merreni Alcet sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Alcet janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gëlltiten me të paktën gjysëm gotë ujë.
Tek të rriturit dhe fëmijët mbi 6 vjeç Alcet jepet nga goja në dozat 10 mg një herë në ditë ose 5 mg dy herë në ditë.
Fëmijëve nga 2 deri në 6 vjeç u jepet 5 mg një herë në ditë ose 2.5 mg dy herë në ditë për trajtimin e rinitit sezonal alergjik.
Tek pacientët me dëmtim hepatik nevojitet reduktimi i dozës në gjysmën e dozës së zakonshme ditore. Në mënyrë të ngjashme edhe tek pacientët me dëmtim renal rekomandohet përgjysmim i dozës ditore të zakonshme.
Megjithatë doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Alcet:
Në qoftë se keni marrë më shumë Alcet se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Dozat më të mëdha se 10 mg shkaktojnë përgjumje.

Në qoftë se keni harruar të merrni Alcet:
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË ALCET

Si të gjithë barnat e tjera, Alcet mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Cetirizina ndikon pak ose aspak në efektet psikomotore duke pasur një incidencë të përgjumjes të ngjashme me atë të placebos. Efektet anësore të raportuara gjatë përdorimit të saj në dozat e rekomanduara janë të pakta dhe të ngjashme me ato të placebos.
Të tilla janë:

- përgjumja;
- dhimbja e kokës;
- marrje mendsh;
- axhitim;
- tharje goje;
- diskomfort gastrointestinal.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ALCET

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Alcet pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështira.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Alcet
Lënda vepruese është cetirizinë klorhidrat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 10 mg cetirizinë klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, glikolat natriumi i amidonit, kroskarmelozë natriumi, talk, stearat magnezi, opadry II i bardhë.

Përmbajtja e paketimit
Forma e paketimit:
kuti me 20 tableta të veshura me film.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.